

VENDIM
Nr. 350, datë 19.4.2017

**PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT
TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN**

(ndryshuar me VKM nr. 624, datë 28.9.2022; nr. 240, datë 20.4.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ndryshuar, të pikave 1, shkronja “a” dhe 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave për gradë dhe shtesave mbi pagë, për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

2. Struktura dhe nivelet e pagave bazë për gradë, për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, janë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, për çdo vit vjetërsi shërbimi, përfitojnë shtesë mbi pagë, në masën 1 për qind për çdo vit, deri në 25 vjet. Kjo shtesë llogaritet mbi vlerën e pagës bazë të gradës “Asistent zjarrfikës”. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite shërbimi do të konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara në librezën e punës së çdo punonjësi, në strukturat e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Forcave të Armatosura, Policisë së Burgjeve, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, *Policisë së Shtetit* si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.

4. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e shtesës së vjetërsisë në shërbim, vetëm për efekt pagese, janë vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa grada, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Punëve të Brendshme e të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.

5. Vendimi nr.438, datë 13.7.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2017, të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, për politikat e reja të pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 mars 2017.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin

(zëvendësuar me VKM nr. 624, datë 28.9.2022; nr. 240, datë 20.4.2023)

Niveli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
1	2	3	4
Niveli bazë	Asistent zjarrfikës	46 000	7 000
	Zjarrfikës	52 500	8 000
	Kryezjarrfikës	55 000	8 000
Niveli i mesëm	Inspektor zjarrfikës	64 200	6 000
	Kryeinspektor zjarrfikës	74 500	6 000
	Komisar zjarrfikës	97 500	6 000
Niveli i lartë	Drejtues zjarrfikës	108 000	
	Drejtues i parë zjarrfikës	120 000	
Niveli madhor	Drejtues i lartë zjarrfikës	131 500	